

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *MBIKËQYRJE PUNIMESH PËR RIKONSTRUKSIONIN E DIGËS DOMEN, BASHKIA RROGOZHINË*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 71521000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.171.782 (nje milion e njqind e shtatedhjete e nje mije e shtateqind e tetedhjete e dy) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 10 të DST

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së parashikuar të kontratës. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022,2023,2024** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të ketë raport negativ, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK e konsideron të rëndësishëm në lidhje me realizimin e kontratës objekt prokurimi.

2.2.3 Vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe kështu për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit).

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat vendore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në bazën të pikës 2, të nenit 76, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 43, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40%** të vlerës së perllëgoaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori / et duhet të jenë të pajisur me Licenca Profesionale për realizimin e shërbimit të mbikëqyrjes, objekt i kontratës:

- N.P -1 Punime gërmimi në tokë
- N.P – 6b Diga të vogla
- N.P – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit
- N.S – 18 Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj, të bëhet njehsimi i licences profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucioneve përkatëse, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentime: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016 si dhe ndryshuar me VKM-nw Nr. 267, datë 2.5.2024.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf Teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mbikëqyrjes në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe në listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit si mëposhtë:

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier gjeodet / topograf 1 (një)
- Inxhinier mjedisi / kimist teknolog 1 (një)
- Inxhinier gjeolog 1 (një)

Për punonjësit e mëposhtëm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe diplomat përkatëse. Ky kriter konsiderohet I përmbushur nepermjet Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit.

Argumentimi: Bazuar ne piken 4 te nenit 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 6/ç e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar), kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

NJESIA E PROKURIMIT